

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Sot me date 19/12/2024 une I nenshkruari **Ardita Duçellari** lindur me 22/08/1981 i identifikuar me karte identiteti me nr 033357632 dhe ID I15822164J

Ne baze te ligjit 9901 date 14/04/2008 “per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare” dhe ligjit 9723 date 03/05/2007 per QKR. Kam vendosur te themeloj shoqerine tregtare SH.P.K te emertuar **“EUROPEAN ENERGIES”**. Duke nenshkruar kete Akt Themelimi. Aktiviteti i saj do te rregullohet nga statuti i saj i cili do te jete pjese perberese e ketij kti themelimi

Neni 1- Emertimi i shoqerise

Shoqeria eshte person juridik I te drejtes shqiptare , **SHOQERI ME PERGJEJEJSI TE KUFIZUAR**. (me poshte e quajtur “SHOQERIA”)

Neni 2 - Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë **“EUROPEAN ENERGIES”** sh.p.k do të shtrihet në këto fusha veprimi:

Tregtimi me shumice dhe pakice I qymyreve te ndryshme,export dhe import I qymyreve, prodhim, transmetim, shperndarje te energjise elektrike. Projektimi, ndertimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i centraleve per prodhimin e energjise elektrike dhe infrastrukturen e impianteve. Kerkimi, zhvillimi dhe menaxhimi i impianteve, sistemeve dhe aparaturave per prodhimin, shperndarjen dhe transmetimin e energjise elektrike. Asistenca teknike, riparime dhe mirembajtje e aparaturave per prodhimin e energjise. Import - eksporti, tregtimi me shumice dhe pakice i energjise elektrike, mallrave, materialeve dhe aparaturave qe lidhen me kryerjen e aktivitetit te shoqerise dhe te lejuara nga legjislacioni ne fuqi per kete lloj shoqerie.

Neni 3 – Selia

Shoqëria e ka selinë ne Qytetin e Lushnjes, ne adresen **Lushnje, lagjja Loni Dhamo, rruga Shetitorja e Palmave, pallati nr 37 apt 25, zk 8572.**

Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, agjencive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të Ortakeve te kesaj shoqerie.

Shoqeria sipas parashikimeve te ketij statuti dhe legjislacionit ne fuqi, mund te hape si ne Shqiperi dhe jashte saj, qendra, perfaqesi, filiale, dege dhe shoqeri te tjera.

Neni 4- Kohezgjatja

Kohezgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qendës Kombëtare të Regjistrimit. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 5 – Kapitali aksionar

Kapitali aksionar do të jetë **500 000 (peseqind mijë) leke. I ndarë në 1 kuota me vlerë dhe në zotërim si më poshtë :**

1. Ardita Duçellari, 1 kuota me vlerë 500 000 (peseqind mijë) leke

Neni 6- Administrimi

Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta dhe jo ortak, të cilet emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e zakonshme. Administratori/et qëndrojnë në postin e tyre për pesë vjet financiarë, me mundësi për të rizgjedhur.

Administratori/et kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë dhe në emër të saj, në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.

Administrator i shoqërisë është Z. **Ardita Duçellari** për një afat 5 (pesë) vjetçar .Ajo do të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit(QKR).

Të gjitha shpenzimet që do të kryen deri në regjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfaqësohen në bilanci të shoqërisë.

Neni 7- Ekspertët Kontabel të Autorizuar.

Shoqëria do të kontrollohet nga një ose disa eksperte kontabel të autorizuar të zgjedhur nga lista e Institutit të Eksperteve Kontabel të Autorizuar. Në caktimin e eksperteve kontabel të autorizuar mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtueshmëritë e percaktuara nga ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Eksperti/et kontabel të autorizuar emërohen nga asambleja e përgjithshme, në afatet e parashikuara nga ligji, me të drejtë rizgjedhjeje në kushtet e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme.

Detyrimet dhe të drejtat e Eksperteve Kontabel të Autorizuar të shoqërisë janë ato të parashikuara nga ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Raportet që ata përgatisin depozitohen në selinë e shoqërisë, në afatet e parashikuara nga ligji.

Neni 8- Viti financiar dhe bilanci vjetor.

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar, pranë Qendës Kombëtare të Regjistrimit, dhe përfundon në 31 dhjetor të të njëjtit vit.

Pasqyrat financiare,raporti i administrimit dhe raporti i ekspertit/ve kontabel te autorizuar miratohen nga asambleja e pergjithshme ne kushtet e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme.

Miratimi i dokumentave qe lidhen me vitin financiar duhet te behet brenda 6 (gjashte) muajve qe nga fundi i vitit financiar.

Neni 9 - Dispozita te pergjitheshme

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje me permbajtje dhe vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe dhe u miratua nen per nen nga aksioneri themelues dhe u nenshkrua ne cdo flete me emer mbiemer dhe nenshkrim me vullnet te lire

ORTAKU THEMELUES

Ardita Duçellari